



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.372/2017

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative,** me gjyqtaren Anita Nikçi-Morina dhe zyrtari ligjor Erand Vokshi, në konfliktin administrativ të paditësit M.Z.nga fshati P. e E., Komuna e P., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Republikës së Kosovës/Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtuar në prani të paditësit dhe në mungesë të të paditurës, me datë 12.06.2018, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit M.Z.nga P., **ANULOHET** vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me numër të dosjes 6019462 i dt. 10.01.2017 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

### A r s y e t i m

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje administrative është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të paditësit dhe në mungesë të të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt.

Në seancën e datës 12.06.2018 paditësi ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadi së duke i kërkuar gjykatës që ti njihet e drejta e shfrytëzimit të pensionit me aftësi të përhershme, pasi që ka dorëzuar pranë gjykatës dokumente mjekësore dhe po ashtu fotot ku shihet gjendja e tij shëndetësore, andaj duke u bazuar nga provat e dorëzuara i ka propozuar gjykatës ti njihet kjo e drejtë ngase edhe gjendja e tij ekonomike është e dobët, sepse janë 5 anëtarë të familjes dhe ai me bashkëshorten e tij janë të dytë pa punë, si dhe kontrollet rutinë janë të kushtueshme dhe është e pamundshme ti përballon shpenzimet.

E paditura me përgjigjen në padi të dt. 15.05.2018 ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke theksuar se pretendimet e palës paditëse për shkelje ligjore nuk qëndrojnë, pasi që vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me asnjë provë. I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadi së paditësit në tërësi si të pabazuar duke lënë në fuqi vendimet e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata në seancën e datës 12.06.2018 ka bërë administrimin e provave relevante dhe atë: padia e dt. 28.02.2017, vendimi i dt. 10.01.2017, dokumentet mjekësore të dt 30.02.2017, raporti specialistik i dt. 30.01.2017

lëshuar nga qendra Neuromedika, dokumentet mjekësore të dt. 14.12.2016, fotokopja e letërnjoftimit e paditësit, raporti specialistit i dt. 11.02.2017, kartela sociale me afat deri me dt. 01.10.2018, raportet mjekësore të dt. 01.02.2017; 01.05.2018; 21.05.2018.

Paditësi i ka ofruar gjykatës në shikim edhe rëntgenin ku shihet gjendja e tij trupore.

Gjykata pasi vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe thënieve gjatë shqyrtimit gjyqësor-kryesor, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar .

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtut ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lëmvive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së paditësit M.Z.ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e dt. 13.12.2016, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë, në përputhje me nenin 5.9 të Ligjit PAK dhe ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme siç përcaktohet me Ligjin 04/131, me ç ‘rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Nga Udhëzimi për konsultim i Qendrës së Mjekësisë familjare dhe Raportet mjekësore të prezantuara nga paditësi, dhe nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se i njëjti ka gjendje të rëndë shëndetësore dhe është i paafte për punë ndërsa me vendimin e atakuar paditësit i është refuzuar pensioni, pa dhënë detaje apo arsye pse është refuzuar.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të marr vendim të drejtë, të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur , duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKS-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.372/2017 dt. 12.06.2018

G j y q t a r j a  
Anita Nikçi-Morina

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.